

Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

Prill, 2017


Tiranë, më 19 Maj 2017: Numri i shtetasve shqiptarë dhe të huaj të hyrë në territorin shqiptar, në muajin Prill 2017 është 764.485. Krahasuar me Prill 2016, ky tregues rezulton me rritje 17,8 %. Numri i shtetasve të huaj të hyrë në vend është 359.452. Krahasuar me Prill 2016, ky numër është rritur me 25,7 %.

Numri i shtetasve të huaj të hyrë në vendin tonë në katërmujorin e parë 2017 është rritur 13,4 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2016.

Shtetasit shqiptarë dhe të huaj të dalë nga vendi gjatë muajit Prill 2017 janë 766.779 duke shënuar një rritje me 23,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Prill 2017 është 429.126. Krahasuar me muajin Prill 2016 ky numër është rritur 17,3 %.

Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i vendit tonë në katërmujorin e parë 2017 është rritur 5,8 %, krahasuar me njëjtën periudhë të një viti më parë.

Fig. 1 Hyrje-daljet e shtetasve në Shqipëri , Prill 2017



Për publikim 19/05/2017

Tab.1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj, Prill 2017

Periodha	Prill-16	Prill-17	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Prill 16	Janar-Prill 17	Ndryshimi vjetor progresive (%)
Hyrje Gjithsej	648.988	764.485	17,8	2.118.185	2.281.912	7,7
Shqiptarë	363.086	405.033	11,6	1.270.335	1.320.520	4,0
Të Huaj	285.902	359.452	25,7	847.850	961.392	13,4
Dalje Gjithsej	619.664	766.779	23,7	2.245.085	2.440.395	8,7
Shqiptarë	365.914	429.126	17,3	1.394.169	1.475.239	5,8
Të Huaj	253.750	337.653	33,1	850.916	965.156	13,4

Numri i vizitorëve të huaj, të hyrë në Shqipëri për qëllime pushimi dhe vizita ditore në muajin Prill 2017, rezulton 126.789, ndërsa në Prill 2016 ky numër ishte 63.911.

Në Shqipëri, numri i shtetasve të huaj që kanë hyrë për qëllime personale në Prill 2017 është 353.374 dhe përbëjnë 98,3 %, të numrit gjithsej të hyrjeve të shtetasve të huaj. Krahasuar me Prill 2016, numri i shtetasve të huaj për qëllime personale është rritur 25,9 %.

Numri i shtetasve të huaj të hyrë në Shqipëri për qëllime biznesi përbën 1,7 % të hyrjeve të shtetasve të huaj, duke shënuar një rritje prej 16,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab.2 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit, Prill 2017

Periodha	Prill-16	Prill-17	Janar-Prill 16	Janar-Prill 17
Hyrje Shtetas të Huaj	285.902	359.452	847.850	961.392
I. Personale	280.683	353.374	831.357	943.201
1. Pushime	38.183	119.921	91.577	234.779
2. Vizitë në miq e të afërm	682	1.212	3.854	3.414
3. Vizitë ditore	25.728	6.868	31.089	24.069
4. Trajtim shëndetësor	79	42	227	222
5. Qëllime fetare	99	52	353	184
6. Vizitorë të tjerë	203.714	206.163	660.077	636.013
7. Udhëtarë tranzit	12.198	19.116	44.180	44.520
II. Biznes dhe profesionale	5.219	6.078	16.493	18.191


Hyrjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj, në rrugë tokësore zënë peshën më të madhe të hyrjeve gjithsej me 81,8 %, ndërsa hyrjet në rrugë ajrore dhe detare zënë respektivisht 12,7 % dhe 5,5 %.

Tab.3 Lëvizjet e shtetasve sipas mënyrës udhëtimit, Prill 2017

Periudha	Hyrje gjithsej			Dalje gjithsej		
	Ajër	Det	Tokë	Ajër	Det	Tokë
Prill-16	75.138	30.269	540.581	73.187	31.398	515.079
Prill-17	97.096	42.271	625.118	93.454	43.802	629.523
Ndryshimi vjetor (%)	29,2	39,7	15,6	27,7	39,5	22,2
Janar - Prill 2016	285.178	105.345	1.724.662	286.394	135.362	1.823.329
Janar - Prill 2017	344.940	111.311	1.825.661	353.551	149.825	1.937.019
Ndryshimi vjetor progresivë (%)	21,0	5,7	5,9	23,4	10,7	6,2

Numri më i madh i hyrjeve të shtetasve të huaj në vendin tonë, në muajin Prill rezulton nga Kosova me 35,0 %, pasuar nga hyrjet e shtetasve të huaj nga Maqedonia me 13,7 %, Greqia me 12,2 %, Mali i Zi me 9,2 %, etj.

Fig. 2 Shtetet me hyrjet më të mëdha në Shqipëri



Metodologji

Përkufizime

Vizitorë: Për qëllime të statistikës së turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

Hyrjet: Përfshijnë të gjitha hyrjet në kufi.

Hyrjet është një koncept që i referohet të gjitha arritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

Daljet : Përfshijnë të gjitha daljet në kufi. Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës.

Qëllimi kryesor i vizitës është qëllimi pa të cilën udhëtimi nuk do të kryhej. Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për arsye:

Vizitat për *qëllime personale*

1. Pushime
2. Vizitë në miq e të afërm
3. Vizitë ditore
4. Trajtim shëndetësor
5. Qëllime fetare
6. Vizitorë të tjerë
7. Udhëtarë tranzit

Kategoria e biznesit përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Punëve të Brendshme (Drejtoria e Policisë së Shtetit).

Të dhënat e muajit të fundit janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/cilesia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor.

Për t'u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT: <http://www.instat.gov.al/>